

BESIMI NË ENGJËJ

*dhe ndikimi i kësaj në jetën e
njeriut*

SALIH EL-FEUZAN

Besimi në engjëjt

**dhe ndikimi i kësaj në
jetën e umetit**

Salih el-Feuzan

Hyrje

I gjithë lavdërimi i takon Allahut, Zotit të gjithë çfarë ekziston, dhe paqja e bekimet qofshin mbi pejgamberin tonë Muhamed, si dhe mbi familjen dhe të gjithë shoqëruesit e tij. Më tej:

Vërtet, besimi [imani] është një çështje e madhe, meqë ai është themeli mbi të cilin varet sukcesi në këtë jetë dhe në tjetrën. Kështu, ai është një nga gradat më të rëndësishme të fesë, ngaqë kur engjëlli Xhibril erdhi tek pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] në praninë e Sahabëve, ai e pyeti atë rreth islamit, imanit dhe ihsanit, duke thënë: "O Muhamed, më trego çka është Islami". Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] u përgjigj: "Islami është të dëshmosh që nuk ka perëndi që meriton të adhurohet përveç Allahut dhe që Muhamedi është i dërguar i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh në muajin Ramazan, dhe ta bësh Haxhin në

Shtëpinë [Ka'ba] nëse ke mundësi për këtë". Kështu ai shpjegoi Islamin si zbatim të pesë shtyllave:1) Dy dëshmitë e besimit, 2) Falja e namazit, 3) Dhënia e zekatit, 4) Agjërimi në Ramazan, 5) Pelegrinazhi në Ka'ba. Engjëlli Xhibril i tha:"Të vërtetën ke thënë. Tash më trego çka është imani".

Pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] tha:"Kjo është të besosh në Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit, dhe të besosh në kader - në të mirën dhe të keqen e tij". Kështu, ai [salallahu alejhi ue selam] shpjegoi që imani është të besosh në gjashtë gjëra: në Allahun, engjëjt e tij, Librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit, dhe el-Kader – të mirën dhe të keqen e tij.

Xhibrili vazhdoi: "Më trego çka është *ihsani*?" Pejgamberi u përgjigj:"*Ihsan* është ta adhurosh Allahun sikur ta shohësh Atë. Por, nëse ti nuk e sheh Atë, vërtet Ai të sheh ty".

Këta janë tre gradat e fesë: Islami, pastaj imani, pastaj *ihساني*. Secila nga këto grada ka shtyllat e veta.

Shtylla është pjesa mbi të cilën qëndron diçka. Si shtyllë e një shtëpie i referohet pjesës mbi të cilën është themeluar shtëpia. Kështu, Imani [besimi] qëndron mbi këto gjashtë shtylla. Nëse një nga këto shtylla mungon, individi s'është më besimtar që ka besim, meqë atij i mungon një nga shtyllat e imanit.

Ndaj, imani s'mund të vendoset përveç se mbi shtyllat e veta, mu sikur një ndërtesë që s'mund të vendoset përveç se mbi shtyllat e veta. Këto gjashtë shtylla [të imanit] janë përmendur në Kur'anin fisionik. Nganjëherë ato përmenden së bashku dhe herëve tjera përmenden veças, siç thotë Allahu: "**Devotshmëri është ai që beson në Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe pejgamberët**".[el-

Bekare, 117]. Allahu përmend pesë shtyllat e imanit në këtë ajet.

Dhe Ai thotë:"I dërguari [Muhamed] beson në çfarë i është shpallur nga Zoti i vet dhe [po ashtu] besimtarët. Të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, dhe të dërguarit e Tij. S'bëjmë dallim mes të dërguarve të Tij". [el-Bekare, 285]

Ai këtu përmend katër nga këto shtylla. Dhe nganjëherë, Ai përmend vetëm dy nga këto shtylla: besimin në Allahun dhe Ditën e Fundit, siç thotë Ai:"**Vërtet, ata që besojnë dhe ata që janë Çifutë, të Krishterë dhe Sabianë; kushdo që beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit**".[el-Bekare, 62]

Ai përmend dy shtylla në këtë ajet: besimin në Allahun dhe në Ditën e Fundit.

Për sa i përket besimit në el-Kader [paracaktimin hyjnor], kjo është

përmendur në thënien e Tij: "Vërtet, ne krijuam gjithçka me Kader [paracaktim hyjnor]". [el-Kamer, 49]

Dhe thënia e Tij: "Ai ka krijuar gjithçka dhe ka caktuar vendim për gjithçka". [el- Furkan, 2]

Domethënia e besimit në engjëjt

Tema në të cilën po përqendrohemi tash është besimi në engjëjt, që është një nga shtyllat e imanit. Ajo në çfarë detyron besimin në engjëjt, është: të besosh në ekzistencën e tyre dhe në detyrat e tyre, të cilat i kryejnë ata në univers.

Kështu, engjëjt janë një nga krijesat e Allahut, të cilat Ai i ka krijuar për qëllimin e adhurimit të Tij dhe për të zbatuar urdhrat në univers. Allahu dërgon engjëjt e vet me qëllim që t'i zbatojnë urdhrat e Tij. Pra, ata janë nga bota e padukshme. Ne s'i shohim ata, megjithëkëtë besojmë në ta me një bindje të fortë, në të cilën dyshimi s'mund të depërtojë. Kjo meqë Allahu na ka informuar rreth tyre, dhe njëloj i dërguari i Tij [salallahu alejhi ue slam] na ka informuar rreth tyre në mënyrën e cila na bënë të besojmë në ta.

Prej çfarë qenë krijuar engjëjt?

Engjëjt qenë krijuar nga drita, siç është transmetuar në një hadith, që Allahu ka krijuar engjëjt nga drita dhe Ai ka krijuar djajtë nga zjarri, si dhe ka krijuar njerëzit nga dheu. Pra, engjëjt qenë krijuar nga drita.

Cilësitë e engjëjve

Së pari: Ata janë ushtritë më madhështore të Allahut. Allahu thotë: **"Allahut i përkasin ushtritë e qiejve dhe tokës"**. [el-Fet'h, 4] Dhe, ndërsa flet për kujdestarët e Zjarrit të xhehenemit, Ai përmend: **"Atë e ruajnë nëntëmbëdhjetë [engjëj]"** [el-Muddethir, 30]. Dhe thotë: **"Për ta ruajtur xhehenemin s'kemi vendosur tjetër veçse engjëj, dhe s'e kemi bërë numrin e tyre për tjetër veçse për t'i provuar mosbesimtarët"**. [el-Muddethir, 31]

Pra, kjo do të thotë që janë nëntëmbëdhjetë engjëj që ruajnë xhehenemin. Ata përkujdesen për të, e ruajnë, e ndezin, dhe u janë lënë në dorëzim çështjet e tij.

Kur një nga mosbesimtarët dëgjoji për numrin e engjëjve që ruajnë xhehenemin, tha, duke u tallur me numrin e tyre: "Unë do t'ju mjaftojë kundra tyre", që do të thotë se nëse ai hyn në xhehenem, do t'i luftojë ata, do t'i mbizotërojë dhe do të dalë nga xhehenemi. Ai e tha këtë me qëllim për të përqeshur dhe qesëndisur, por Allahu i përgënjeshtroi ata duke thënë: **"Për ta ruajtur xhehenemin s'kemi vendosur tjetër veçse engjëj"** [el- Muddethir, 31]. Kjo do të thotë që ata s'do të jenë njerëz.

Nëse ky person pohon që është i fortë dhe është i aftë të luftojë kundra një numri njerëzish, ai do të s'do të jetë në gjendje të luftojë madje edhe kundra një

engjëlli të vetëm. Allahu thotë: "**Për ta ruajtur xhehenemin s'kemi vendosur tjetër veçse engjëj**" [el-Muddethir, 31]. Kjo do të thotë: s'i kemi bërë ata njerëz apo xhinë.

"Dhe s'e kemi bërë numrin e tyre për tjetër veçse për t'i sprovuar mosbesimtarët, me qëllim që njerëzit e Librit të binden dhe besimtarëve t'u shtohet imani, dhe në mënyrë që të mos ketë më dyshime për njerëzit e Librit dhe besimtarët, si dhe që ata, të cilët kanë në zemrat e veta sëmundje [të hipokrizisë] dhe besimtarët, të thonë: 'Çfarë deshi Allahu me këtë shembull'". [el-Meddethir, 31]

Kështu ata gënjejnë dhe mundohen ta nënvleftësojnë numrin e tyre. Si mund t'i bëhet përkujdesje nga vetëm nëntëmbëdhjetë këtij xhehenemi të stërmadh, i cili përmban gjithë këto krijesa? Allahu thotë: "**Dhe s'e kemi bërë numrin e tyre për tjetër veçse**

për t'i sprovuar mosbesimtarët".[el-Muddethir, 31]

Pra, askush nuk e njeh madhësitinë e engjëjve dhe askush nuk di çfarë ka Allahu nga ushtritë në qiej dhe tokë, përveç Allahut. As këta mosbesimtarë, as ndokush tjetër.

E dyta: Këta engjëj kanë një ndërtim fizik madhështor, siç e përmend Allahu këtë në thënien e vet: **"I gjithë lavdërimi i takon Allahut, Shpikësit të qiejve dhe tokës, i cili bëri të dërguarit engjëj me krahë - me nga dy, tre dhe katër".[Fatir, 1]**

Kjo do të thotë që ka disa engjëj që kanë nga dy krahë, disa që kanë nga tre dhe disa nga katër. Dhe, ka disa engjëj që kanë më shumë krahë se kaq, ngase pejgamberi [salallahu alejhi ue selam] e ka parë Xhibrilin dhe ai kishte 600 krahë, ku secili krah bllokonte fushëpamjen. Ky është vetëm një nga shumë engjëjt që ekziston. Allahu e

përshkruan atë si të fuqishëm, siç thotë: "**Ai [Muhamedi] ka qenë mësuar [me këtë Kur'an] nga ai që është i fuqishëm**" [en-Nexhm, 5]. Ai këtu po i referohet Xhibrilit. "**I pastër nga çdo e metë. Pastaj u ngrit [dhe u fiksua]**" [en-Nexhm, 6]. Kjo do të thotë që ai posedon fuqi dhe një dukje të bukur.

Së treti: Engjëjt kanë një fuqi të madhe me lejen e Allahut. Ajo çfarë tregon fuqinë e madhe të tyre është që, nëse Allahu e urdhëron vetëm njërin nga ata, ai vërtet është i aftë ta lëshojë një britmë të tmerrshme në botën, kështu duke shkatërruar gjithë krijimin, siç ka ndodhur me popullin e Themudit, të cilët qenë ndalur nga një britmë e fortë. Xhibrili ka lëshuar një britmë tepër të fuqishme mbi ta - "**Vërtet, Ne dërguam kundra tyre një *sajha* [britmë jashtëzakonisht të madhe] të vetme, dhe ata u bënë si kashtë skerme**".[el-Kamer, 31]

Kështu, zemrat e tyre pushuan së rrahuri brenda trupave të tyre dhe si pasojë ata vdiqën dhe u bënë si kashtë. Ka qenë ndër zakonet e Arabëve që, kur të vendoseshin në ndonjë vend, ata do të mblidhnin shkopinj [drurë] dhe do të bënin skermë [gardh] për t'i rrethuar delet dhe bagëtitë e veta. Këto skerma përfundimisht do të thaheshin dhe të bëheshin kashtë. Kështu që pavarësisht fuqisë së Themudit, ata u bënë sikur kashtë, si pasojë e një britme të vetme nga njëri ndër engjëjt. Allahu po ashtu ka urdhëruar Xhibrilin të ngrejë qytetet e popullit të Lutit, dhe ato qenë shtatë qytete, në të cilat mund të gjendeshin njerëz, ndërtesa, mall dhe kafshë. Ai i mbarti në njërën anë të krahut të vet dhe i ngriti këto qytete derisa engjëjt [e tjerë] dëgjuan lehjen e qenve dhe gugatjen e gjelave. Pastaj i përmbysi dhe Allahu bëri që toka t'i gllabërojë.

Ky është një shembull i fuqisë së madhe

të engjëjve.

Po ashtu është engjëlli Israfil, engjell të cilit i është lënë në dorëzim fryrja në Trombë [Sur]. Çfarë mendohet me Trombë është një bri që do të mbledhë gjithë shpirtrat e njerëzve, nga i pari e deri të i fundit. Pastaj Israfil do të fryjë një herë në Trombë dhe shpirtrat do të fluturojnë përreth për shkak të kësaj fryrje të bririt, duke u kthyer pastaj prapë në trupat e vet. Kjo njihet si Fryrja e Ringjalljes [*Nafkhat-ul-Ba'ath*]. Përpara kësaj, ai do t'i bie Fryrjes së Shkatërrimit [*Nafkhat-us-Sa'ak*], kështu që çdonjëri në qiej dhe tokë do të vdesë, përveç atij që do Allahu. Allahu thotë: **"Dhe Trombit [Surit] do t'i fryhet dhe të gjithë që janë në qiej dhe tokë do të zalisen, përveç atij që do Allahu"** [ez- Zumer, 68]. Zalisje do të thotë vdekje. Pastaj ai do t'i fryjë Trombit prapë, fryrje e cila njihet si Fryrja e Ringjalljes - **"Vë re! Ata do të qëndrojnë duke shikuar"**. [ez-Zumer, 68]

Kjo është me vetëm një engjëll të Allahut dhe kjo është vetëm një nga detyrat e tij, të cilën Allahu e ka urdhëruar ta zbatojë. Ndaj, engjëjt janë nga krijesat madhështore të

Allahut. Ai i ka krijuar ata që ta dhurojnë Atë dhe t'i zbatojnë urdhrat e Tij. Allahu thotë: **"Ata janë robër të ndershëm të Tij. Ata nuk flasin derisa të flasë Ai dhe veprojnë sipas urdhrave të Tij. Ai e di çfarë ka përpara tyre dhe pas tyre, dhe ata s'mund të ndërmjetësojnë, përveç për atë me të cilin Ai është i kënaqur. Ata qëndrojnë me frikë- respekt ndaj Tij".**[el-Enbija, 26-28]

Ky është një përshkrim i engjëjve.

Engjëjt kanë detyra. Secili prej tyre ka një detyrë që i është lënë në dorëzim, dhe ai nuk e vonon zbatimin e saj. Ai e kryen atë duke vepruar sipas urdhrit të Allahut dhe nuk e kundërshton atë.

Allahu thotë:

"[Xhehenemi] Mbi të cilën janë engjëjt e vrazhdë e të ashpër, të cilët nuk kundërshtojnë urdhrat që pranojnë nga Allahu, por bëjnë çfarë urdhërohen".[et-Tahrim, 6]

Disa nga detyrat e tyre

Së pari: Ata që janë përgjegjës për xhehenemin. Ata njihen si kujdestarë të xhehenemit, që do të thotë: ata të cilëve u është lënë në dorëzim xhehenemi dhe torturimi i banuesve të tij.

Së dyti: Midis tyre janë engjëjt të cilëve u është lënë në dorëzim mbartja e Fronit të Allahut, siç thotë Ai:

"Ata që mbartin Fronin [e Allahut] dhe ata rreth tij e madhërojnë me lavdërime Zotin e vet dhe besojnë në Të. Dhe, ata kërkojnë falje për ata që besojnë [duke thënë]: 'Zoti ynë! Ti përfshin gjithçka me mëshirë dhe dije. Pra, fali ata që pendohen'". [Gafir, 7]

Dhe Allahu thotë:

"Atë Ditë Fronin e Zotit tënd do ta mbartin tetë [engjëj]". [el-Hakkah, 17]

Numri i engjëjve që mbartin Fronin:

Engjëjt që do ta mbartin Fronin janë katër. Pastaj, në Ditën e Gjykimit numri i tyre do të shtohet në tetë. Froni i Allahut është krijesa më madhështore, që do të mbartet në Ditën e Gjykimit nga tetë engjëj. Kjo tregon që ata vërtet janë të fuqishëm, meqë do të mbartin Fronin madhështor, i cili është krijesa më e madhe dhe më e gjerë e Allahut. Kjo tregon fuqinë dhe vetëpërmbajtjen e tyre.

Së treti: Midis tyre janë ata engjëj që u është lënë në dorëzim shpallja. Allahu thotë:

"Ai ia zbret engjëjt me *Rruh* [shpirt/shpallje] nga urdhri i Tij kujt të dojë nga robërit e vet [duke thënë]:'Paralajmëro njerëzimin që s'ka perëndi tjetër që meriton të adhurohet përveç Meje, kështu që binduni'".[en-Nahl, 2]

Fjala *Rruh* [shpirt] këtu do të thotë shpallje. Quhet *Rruh* ngaqë është shpallje që u sjell jetë zemrave, mu siç shiu i sjell jetë tokës. Në kuptimin e njëjtë, është *Rruh* [shpirti] i krijuar që u sjell jetë trupave të shtazëve.

Rruh po ashtu mund të qëndrojë për Kur'anin, siç thotë Allahu:

"Dhe kështu ta kemi shpallur [O Muhamed] një *Rruh* [dmth Kur'anin] nga urdhri ynë".[esh-Shura, 52]

Rruh këtu qëndron për Kur'anin, meqë kjo u sjell jetë zemrave të besimtarëve, mu siç ngjallet toka me anë të shiut. Po kështu qëndron puna edhe me zemrat besimtarëve – ato ngjallen me anë të Kur'anit.

Fjala *Rruh* po ashtu përdoret për t'iu referuar Xhibrililit, i cili është më i madhi,

më i nderuari dhe më virtuozi nga të gjithë engjëjt. Ai është që solli Kur'anin poshtë nga Allahu tek Muhamedi, siç thotë Allahu:

"Shpirti besnik [Xhibrili] e solli atë [dmth Kur'anin] poshtë - tek zemra jote [O Muhamed] me qëllim që të jesh ndër paralajmëruesit – në një Arabishte të qartë".[esh-Shura, 193-195]

Kështu Xhibrili solli Kur'anin poshtë tek zemra e peygamberit, salallahu alejhi ue selam, dhe ai sipas radhës ia kumtoi atë këtij umeti. Në një tjetër ajet, Allahu thotë:

"Thuaj: shpirti i shenjtë [Xhibrili] e solli poshtë nga Zoti yt". [en-Nahl, 102] Kjo i referohet engjëllit Xhibril. Ai është shpirti i shenjtë.

Cilësitë e Xhibrilit

Allahu e ka përshkruar Xhibrilin me cilësi madhështore, siç thotë Ai:

"Vërtet, bëj be në planetët që tërhiqen [zhduken gjatë ditës dhe shfaqen natën]! Dhe pasha planetët që lëvizin shpejtë dhe fshihen! Dhe Pasha natën kur largohet! Dhe pasha agun kur shkëlqen! Vërtet, kjo është Fjala e prurë nga një engjëll i nderuar, që ka fuqi dhe gradë të lartë tek Zoti i Fronit, dhe i cili dëgjohet [nga engjëjt] dhe është besnik atje [në qiej]".[et-Tekuir, 15-21]

Cilësia e parë e tij: Fuqia. Allahu thotë: **"Që ka fuqi dhe gradë të lartë tek Zoti i Fronit"**. [et-Tekvir, 20] "Zoti i Fronit" këtu i referohet Allahut.

Cilësia e dytë e tij: Pozita. Allahu thotë: **"Që ka fuqi dhe gradë të lartë tek Zoti i Fronit"**. [et-Tekuir, 20] Kjo do të thotë që ai ka një pozitë të lartë në

shikimin e Allahut, të cilin nuk e ka mbërri askush.

Cilësia e tretë e tij: Dëgjueshmëria. Të gjithë engjëjt i binden Xhibrilit me lejimin e Allahut.

Cilësia e katërt e tij: Besnikëria. Kjo i referohet shpalljes, në kuptimin që ai nuk shton apo heq nga ajo, por e bart atë pikërisht siç ia ka shpall Allahu.

Të shikuarit e Muhamedit Xhibrilin

Allahu thotë: "**Shoku juaj s'është i çmendur**" [et-Tekuir, 22]. Kjo është çfarë pohonin mosbesimtarët për të.

"Dhe vërtet ai [Muhamedi] e pa atë [Xhibrilin] në fushëpamjen e qartë" [et-Tekuir, 23]. Muhamedi, salallahu alejhi ue selam, e pa Xhibrilin në fushëpamje dy herë.

Hera e parë: Kjo qe në luginën e Mekës. Pejgamberi Muhamed, salallahu alejhi ue selam, çoi kokën dhe e pa atë në qiell dhe ai kishte 600 krahë. Secili nga krahët e tij bllokonte fushëpamjen.

Hera e dytë: Allahu thotë: **"Dhe vërtet ai [Muhamedi] e pa atë [Xhibrilin] në një zbritje të dytë, pranë drurit të zambakut tek kufiri i fundit"** [en-Nexhm, 13-14]. Kjo i ndodhi atij gjatë natës në të cilën pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, u ngrit në qiell dhe e pa atë në gjendjen e tij normale.

Këto janë cilësitë e Xhibrilit. Allahu thotë:

"Vërtet, kjo është Fjala [e prurë] nga një engjëll i nderuar".[et-Tekuir, 19]

Kjo domethënë: Ndonëse Kur'ani është Fjala e Allahut, ky i përshkruhet Xhibrilin këtu, meqë ai është i cili ia barti

atë Muhamedit. Kështu, ai po i bart fjalët nga Allahu, sepse ia diktoi ato të dërguarit tonë, Muhamedit, duke e bartur atë nga Allahu. Mirëpo, kjo është e folura e Allahut. E folura i atribuohet vetëm atij që e thotë atë në fillim, jo atij që e thotë atë duke e bartur nga dikush tjetër. Mirëpo, e folura e Allahut i është atribuar Xhibrilit këtu nga këndvështrimi kur ai e bart atë.

Së katërti: Ka engjëj që u janë lënë në dorëzim të tjera detyra

Mika'il: Ai është përgjegjës për pikat e shiut që bien nga qielli. Ai i lëviz ato kudo dhe bën që shiu të zbret kurdo qoftë që Allahu do.

Israfili është përgjegjës për fyerjen në Trombë. Kjo do të jetë atëherë kur Allahu do t'i ringjallë krijesat nga varret e tyre. Trupat do të sillen nga varret dhe do të mblidhen përsëri. Atëherë, e vetmja gjë që do të mbetet [pa u integruar] do të jetë shpirti. Në këtë çast

Israfili do të fryjë në këtë Trombë me urdhrin e Allahut, dhe shpirtrat do të pluskojnë për tek trupat e vet përkatës, të cilët qenë dalë dhe nxjerrë nga varret e veta. Atëherë, ata do të ecin për atje ku Allahu i urdhëron të shkojnë. Allahu thotë:

"Ditën kur do të dalin nga varret me ngut sikurse bëjnë garë për tek një synim". [el- Mearixh, 43]

Dhe, Allahu thotë:

"Ata do të dalin nga varret e veta kokulur sikurse të jenë karkaleca të shpërndarë. Duke nxituar drejt thirrësit, mosbesimtarët do të thonë:'Kjo është ditë e vështirë'".[el- Kamer, 7-8]

Këta janë tre engjëjt të cilët janë përgjegjës për jetë. Xhibrili është përgjegjës për prurjen e shpalljes, e cila i jep jetë zemrës. Mika'ili është përgjegjës për shiun, i cili i sjell jetë tokës pas

vdekjes së saj. Israfil i është përgjegjës për fryrjen në Trombë, i cili do t'u sjellë jetë trupave [në Ditën e Ringjalljes]. Kjo është përse pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, kur ngrihej për namaz të natës, pasi shqiptonte tekbirin hapës, thoshte në lutjen e tij hapëse: "O Allah! Zoti i Xhibrilit, Mika'ilit dhe Israfil. Shpikës i qiejve dhe tokës..."

Këta janë engjëjt më të mëdhenj për shkak të rëndësisë së detyrave të tyre.

Së pesti: Po ashtu ka engjëj që janë përgjegjës për fetuset brenda në mitrat e nënave. Kjo është transmetuar në hadithin e Ibn Mes'udit, radijallahu anhu, në të cilin thotë: "I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selam, na rrëfeu – dhe ai është i vërteti të cilit i besohet – duke thënë: 'Vërtet, krijimi i secilit prej jush mblidhet në mitrën e nënës së vet për dyzet ditë në formë të një fare, pastaj kjo bëhet droçkë [gjak i mpiksuar] për një periudhë të njëjtë,

pastaj kjo bëhet copë mishi për një periudhë të njëjtë, pastaj atij i dërgohet engjëlli i urdhëruar me katër gjëra: që të shkruajë mjetet e jetesës, jetëgjatësinë, veprat, dhe nëse ai do të jetë i lumtur apo i pafat". Allahu ia dërgon këtë engjell për të kryer këtë detyrë të rëndësishme.

Së gjashti: Ka engjëj që janë përgjegjës për marrjen e shpirttrave kur të mbarojë afati i caktuar i tyre. Është engjëlli i vdekjes [*Melek-ul-Meut*], për të cilin Allahu thotë:

"Thuaj: 'Engjëlli i vdekjes, i cili është caktuar për ju, do t'i marrë shpirttrat e juaj'. Pastaj tek Zoti juaj do të ktheheni". [es-Sexhde, 11]

Engjëlli i vdekjes ka ndihmës që do ta ndihmojnë atë, siç thotë Allahu:

"Deri kur vdekja t'i afrohet ndonjërit prej jush, të dërguarit tanë [dmth engjëlli i vdekjes dhe ndihmësit e

vet] marrin shpirtin e tij dhe ata kurrë nuk lënë pas dore detyrën e vet. Pastaj ata i kthehen Allahut, **Padronit të tyre, Zotit të drejtë"** [el-En'am, 61-62]. Marrja e shpirtit në çastin e vdekjes i përshkruhet engjëjve, engjëllit të vdekjes dhe po ashtu Allahut.

"Është Allahu ai që merr shpirtrat në çastin e vdekjes së tyre". [ez-Zumer, 42]

Vdekja i përshkruhet Allahut këtu ngaqë Ai është i cili urdhëron që kjo të ndodhë. Po ashtu i përshkruhet engjëjve ngaqë ata janë të cilët kryejnë mbartjen fizike të kësaj, duke mbledhur shpirtin dhe udhëhequr atë jashtë trupit të njeriut derisa ta mbërrijë fytin e tij. Dhe, po ashtu kjo i përshkruhet engjëllit të vdekjes - **"Thuaj: 'Engjëlli i vdekjes, i cili është caktuar për ju, do t'i marrë shpirtrat e juaj'. Pastaj tek Zoti juaj do të ktheheni"** – ngaqë ai është përgjegjës për marrjen e shpirtrave pasi

që ata të jenë mbledhur në fazën e fundit [të vdekjes].

Së shtati: Po ashtu ka engjëj përgjegjës për të shkruar veprat e birit të Ademit [dmth njerëzve], siç qëndron në hadith:"Ju vazhdimisht përcillenit [në ndërrime të njëpasnjëshme] nga engjëjt natën dhe gjatë ditës". Allahu thotë:

"Vërtet, mbi ju ka kujdestarë [dmth engjëj] të ndershëm që shënojnë [veprat e juaja]. Ata dinë gjithë çfarë bëni". [el-Infitar, 10-12]

Çdo qenie njerëzore ka dy engjëj me vete

Çdo njeri midis nesh ka dy engjëj të cilët janë përgjegjës për të – një engjëll në të djathtë, që shënon veprat e tij të mira, dhe një tjetër në të majtë, që shënon veprat e këqija të tij. Allahu thotë:

"Kur dy pranuesit pranojnë [dmth shënojnë veprat e tij] nga e djathta dhe nga e majta e tij, të ulur. Ai nuk e thotë asnjë fjalë të vetme veçse ka një vëzhgues të gatshëm pranë tij [për ta shënuar atë]".[Kaf, 17-18]

Këta engjëj kujdestarë e shoqërojnë njeriun qoftë kur ai është në udhëtim, apo kur është ulur në shtëpi. Ata janë pranë tij gjatë gjithë kohës me çdo kusht – gjatë namazit të tij, ndërsa ai bie në sexhde, etj. Ata e shoqërojnë atë dhe nuk e lënë vetëm, përveç në rrethana të veçanta, siç është kur personi kryen nevojë fiziologjike [në nevojtoire]. Engjëjt shënojnë qëllimet dhe synimet e njerëzve

Është transmetuar që engjëjt po ashtu shënojnë qëllimin dhe synimin e brendshëm të personit, të cilat gjenden në zemër. Çfarëdo qoftë që ai ka qëllim të bëjë, ata e shënojnë atë. Për këtë arsye personi shpërblehet për pasjen e qëllimit

të mirë, meqë kjo është vepër zemre, ndërsa ai dënohet për qëllimet e këqija, meqë qëllimi është vepër zemre. Këta engjëj janë vënë përgjegjës për shënimin e veprave të një personi, prej kohës kur ai mbërrin moshën madhore [mosha e dallimit] e deri në kohën kur Allahu merr shpirtin e tij në vdekje. Dhe, ata shënojnë kundër tij gjithçka që ai bën në jetën e vet, qoftë kjo në formë qëllimesh, veprash, thëniesh, apo tjetër veç kësaj.

Statusi i namazit të Sabahut dhe Ikindisë midis namazeve tjera

Pejgamberi ka thënë: "Ju vazhdimisht përcillen [me ndërrime të njëpasnjëshme] nga engjëjt, natën dhe gjatë ditës. Dhe, ata mbledhen bashkë gjatë namazit të Ikindisë dhe gjatë namazit të Sabahut". Është mu për këtë arsye që këto dy namaze janë më madhështoret nga të gjitha namazet. Allahu thotë:

"Vërtet, recitimi i Kur'anit në agun e hershëm [dmth namazin e Sabahut] dëshmohej [nga engjëjt]".[el-Isra, 78]

Ai këtu po i referohet namazit të Sabahut, të cilin e përcjellin engjëjt e natës dhe të ditës. Ata mblidhen së bashku për të dëshmuar namazin e Sabahut së bashku me muslimanët dhe dëgjojnë Kur'anin që recitohet në namaz. Ata po ashtu mblidhen së bashku gjatë namazit të Ikindisë, ku Allahu i pyet, ndonëse Ai e di më mirë:"Në çfarë gjendje i latë robëritë e Mi?" Engjëjt përgjigjen duke thënë:"U shkuam atyre ndërsa faleshin dhe i lamë ndërsa faleshin". Kjo do të thotë që ata zbritën ndërsa po falnim namazin e Ikindisë dhe morën pjesë në namaz së bashku me ne. Pastaj prapë u ngritën [në qiej] ndërsa po falnim namazin e Sabahut.

Për këtë shkak, është vendosur që namazi i Ikindisë është "namazi i mesëm" për të cilin Allahu na ka nxitur, duke thënë:

"Kujdesu me përpikëri për [pesë] namazet, veçanërisht për namazin e mesëm [dmth Ikindinë]" [el-Bekare, 238]. Ai mendon me këtë në namazin e Ikindisë, meqë ky është namazi që përcillet nga engjëjt e natës dhe të ditës.

Thirrje për të shkujdesurin

Pra, ku janë ata që nuk falin namazin e Sabahut, që flenë në krevatet e veta dhe nuk marrin pjesë në këtë ngjarje madhështore çdo natë me engjëjt e më të Mëshirshmit? Kjo është në atë mënyrë, saqë këta engjëj njoftojnë rreth këtyre pjesëmarrësve [të namazit të Sabahut] në tubimet më të larta, duke thënë: "U shkuam atyre ndërsa faleshin dhe i lamë ndërsa faleshin".

Çfarë dobie ka ky person që përmbahet nga shkuarja në namazin e Sabahut dhe në vend të kësaj parapëlqen gjumin? Dhe çfarë dobie ka ky person që lëshon pjesëmarrjen në namazin e Ikindisë nga përtacia, duke parapëlqyer gjumin apo ndonjë vepër tjetër?

Është thënë në hadith që: "Kushdo që e lëshon namazin e Ikindisë, kjo për të është sikurse të ketë humbur familjen dhe pasurinë e vet". Dhe në një tjetër hadith thuhet: "... atëherë ai ka anuluar veprat e veta". Kjo do të thotë që ai e ka nxjerr namazin jashtë kohës së tij të duhur. Kështu që, nëse ai e nxjerr atë jashtë kohës së tij të duhur, ai e ka humbur atë.

Së teti: Po ashtu ka engjëj që janë përgjegjës për mbrojtjen e njerëzve nga rreziqet. Qenia njerëzore është e prirë për të hyrë në rreziqe çdo ditë. Mirëpo, Allahu ua lë në dorëzim engjëjve dhe e

mbron atë nga këto rreziqe gjatë jetës së tij, të cilat Allahu i ka caktuar për të. Kjo tokë, mbi të cilën qenia njerëzore ecën çdo ditë, përmban shumë rreziqe. Ka kafshë të egra, gjarpërinj, akrepa, të mos e përmendim dhunuesit nga njerëzit: armiqtë dhe tiranët. Mirëpo, Allahu i ka vendosur këta engjëj përreth qenies njerëzore. Allahu thotë:

"Ai [individ] i ka ata [engjëjt] të cilët vazhdimisht e rrethojnë atë, nga përpara dhe prapa tij, duke e mbrojtur atë me urdhrin e Allahut".[er-Rad, 11]

Ndaj, për sa kohë që Allahu ka dekretuar që ky individ do të jetë i sigurt nga dëmet, këta engjëj do ta mbrojnë dhe ruajnë atë, dhe asnjë njeri s'do të jetë në gjendje ta dëmtojë atë. Por, nëse do Allahu t'i japë fund kohës së caktuar të tij, Ai i heq ata prej tij – një nga përpara dhe një nga prapa tij.

"Vërtet, Allahu nuk do ta ndryshojë

gjendjen e një populli derisa ata [së pari] ta ndryshojnë gjendjen e vet. Dhe, kur Allahu dëshiron një përfundim të keq për një popull, nuk ka kthim mbrapa".[er-Rad, 11]

Kështu, nëse paracaktimi i Allahut ndodh dhe Ai dëshiron t'i japë fund këtij personi, engjëjt që vazhdimisht e rrethojnë atë tërhiqen nga ai, ngaqë ata nuk hezitojnë në zbatimin e urdhrave të Tij. Këta janë engjëjt që vazhdimisht e rrethojnë personin.

Së nënti: Po ashtu ka engjëj që kanë përgjegjësi në këtë univers, për çfarë vetëm Allahu ka njohuri. Ka engjëj që janë vënë përgjegjës të deteve dhe engjëj përgjegjës për ditët. Ka edhe engjëj përgjegjës për erërat dhe engjëj përgjegjës për zbatimin e shumë detyrave.

Të gjitha ngjarjet që ndodhin në univers dhe të cilat vazhdimisht përhapen

brenda tij në baza ditore, janë të tilla vetëm me caktimin e Allahut. Për sa u përket engjëjve, ata zbatojnë çfarëdo detyre që Allahu i urdhëron ata për të bërë.

Obligimi i të besuarit në engjëjt dhe të gjitha detyrat e tyre

Këta janë ata engjëj të cilët Allahu i ka emërtuar për ne, siç është Xhibrili, Mika'ili, Israfil dhe Maliku, kujdestari i xhehenemit. Allahu thotë:

"Dhe ata [banorët e xhehenemit] do të bërtasin: 'O Malik! Le ta përfundojë me ne Zoti yt'. Ai do të thotë: 'Vërtet, ju do të banoni këtu përgjithmonë'". [ez-Zuhruf, 77]

Dhe ka të tjerë engjëj të cilët Allahu nuk i ka emërtuar për ne. Mirëpo, besojmë në të gjithë engjëjt – në ata, emrat e të

cilëve i dimë dhe në ata, emrat e të cilëve nuk i dimë. Dhe, besojmë në detyrat që ata zbatojnë me urdhrin e Allahut.

Fushat e dallimit mes veprave të engjëjve dhe veprave të djajve

Engjëjt e madhërojnë me lavdërime Zotin e vet dhe kërkojnë falje për bijtë e Ademit, ndërsa djajtë janë krijesat më tradhtare ndaj bijve të Ademit. Kjo meqë Djalli është betuar që do t'i çorientojë, t'i humbasë dhe t'i shkatërrojë bijtë e Ademit, aq sa do të ketë mundësi ai. Allahu thotë:

"Vërtet, Ne bëmë djajtë përkrahës të atyre që nuk besojnë".[el-Araf, 27]

Së dyti: Engjëjt i urdhërojnë robërit për të mirë, ndërsa djajtë i nxisin dhe i urdhërojnë për të bërë keq.

"Dhe kushdo që kthen shpinën nga

Përkujtimi i më të Mëshirshmit, Ne caktojmë për të një djall që i ngjitet atij. Kështu ai i bëhet shok atij".[ez-Zuhruf, 36]

Pra, personin që largohet nga Kur'ani fisnik, Allahu e dënon duke ia caktuar një engjëll i cili do t'i shërbejë si shoqërues. Allahu thotë:

"Vërtet, ata [dmth djajtë e caktuar] i pengojnë nga rruga e duhur, ndërsa mendojnë që janë të udhëzuar drejt. Kjo derisa personi i tillë të na vijë. Ai pastaj do t'i thotë [shoqëruesit djall të vet]:'Sikur të kishte qenë largësia mes meje dhe teje sa largësia mes dy lindjeve!'. Pra, sa shoqërues i keq, me të vërtetë!".[ez-Zuhruf, 37-38]

Kështu, asgjë nuk e mbron qenien njerëzore nga Djalli, përveç përkujtimit të Allahut. E treta: Përkujtimi i Allahut largon djajtë nga njeriu dhe bën që engjëjt t'i afrohen atij.

Për këtë shkak Djalli quhet *el-Uesues-ul-Khenas* [Pëshpëritësi i së keqes në zemrat e njerëzimit, i cili largohet kur personi përmend Allahun]. Kështu, kur personi ta lë përkujtimin e Allahut, Djalli i vjen i atij; kur ai përkujton Allahun, engjëjt e rrethojnë atë, siç përmendet në hadithin: "Asnjë grup njerëzish nuk tubohet në një nga shtëpitë e Allahut për të lexuar librin e Allahut dhe ta studiojnë atë mes veti, përveç se qetësia zbret në ta, mëshira i mbështjell, engjëjt i rrethojnë dhe Allahu ua përmend ata atyre afër Tij".

Vendet që shpesh vizitohen nga engjëjt

Ka engjëj që udhëtojnë nëpër tokë duke kërkuar tubime ku Allahu përkujtohet. Kur ata gjejnë një tubim të përkujtimit të Allahut, thonë: "Ejani shpejt për tek nevoja juaj".

Përkujtimi i Allahut është shumë llojesh,

ndër to:

Recitimi i Kuranit. Ai që e lexon Kur'anin përkujton Allahun.

Ai që falet përkujton Allahun.

Ai që thotë "SubhanAllah", "Estagfirullah", "Allahu ekber", dhe thotë "La ilahe il- Allah", përkujton Allahun. Kështu tubohen engjëjt rreth tij dhe djajtë largohen prej tij.

Ata që mësojnë dhe studiojnë librat e dijes dhe marrin pjesë në tubime për ta mësuar fenë, përkujtojnë Allahun. Kështu engjëjt mblidhen afër tyre.

Vendet që shpesh vizitohen nga djajtë

Ata që preokupohen me forma të zbavitjes së kotë, siç janë këngët dhe instrumentet [muzikore], këta individë rrethohen nga djajtë që mblidhen rreth tyre, ndërsa engjëjt largohen prej tyre.

Ai që vendos imazhe në shtëpinë e vet, engjëjt nuk hyjnë në shtëpinë e tij, siç qëndron në hadithin, ku pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, ka thënë: "Vërtet, engjëjt nuk hyjnë në shtëpinë që ka qen dhe imazhe". Engjëjt e mëshirës nuk hyjnë në shtëpitë që kanë imazhe, pavarësisht se a qëndrojnë të varura në mur apo të vendosura në albume apo kutia për përkujtim, apo për t'i zbukuruar muret e shtëpisë.

Fotografi këtu u referohet imazheve të gjërave që kanë shpirt. Kjo i largon engjëjt. Mirëpo, ajo që është e lejuar për shkak të domosdoshmërisë, siç është karta e identifikimit, pasaportat dhe të tjera si këto, janë të lejuara për shkak të nevojës për to. Këto imazhe nuk merren me qëllim për t'i admiruar ato. Pra, këto lloj imazhesh janë përjashtim në këtë ndalim. E njëjta vlen për imazhet që shkelen [dmth në dysHEME] dhe në të cilat ulemi. Këtu po flasim vetëm për imazhet që varen për përkujtim apo

magazinohen sa për sy e faqe. Këto janë lloje imazhesh të cilët janë të ndaluara, meqë nuk ka nevojë për to që të bëhen. Këto lloje imazhesh bëjnë që djajtë të vijnë brenda në shtëpi ndërsa pengojnë engjëjt nga hyrja.

Ndikimi që ka besimi në engjëjt në jetën e njerëzve

Besimi në engjëj ka një ndikim të pamasë në jetën e njerëzve, meqë kur personi është i vetëdijsëm për ekzistencën e tyre, ai vërtet do të jetë i kujdesshëm dhe i vëmendshëm. Nëse një person kupton që ka engjëj përgjegjës për të, të cilët vazhdimisht e rrethojnë atë, ditën dhe natën, ai me siguri do të jetë i kujdesshëm për çfarë thotë dhe bën, që mos të shënohet diçka e papërshtatshme rreth tij. Kështu, po ta dinte ai që ka hetues që e ndjekin atë, a s'do të kishte qenë i kujdesshëm nga frika që ata do të mund të shënonin

diçka nga e folura apo veprimi i tij, gjë e cila do t'i shkaktonte atij përfundim të keq?

Pra, si mund ai të mos jetë i kujdesshëm dhe i vëmendshëm për engjëjt kur nuk i sheh ata? Për sa u përket njerëzve, mund t'i shihni ata. Ai që po të sheh ty dhe ti po e sheh atë, je syhapur ndaj tij. Mirëpo, engjëjt të shohin por ti s'mund t'i shohësh ata. Është e mundshme që të jesh i aftë të mbrohesh nga njerëzit – mund të hysh brenda shtëpisë tënde apo të vetmohesh në ndonjë zonë të izoluar, dhe ata s'do të mund të informoheshin rreth teje. Për sa u përket engjëjve, ata hyjnë me ty kudo. Allahu u ka dhënë aftësi për të mbërri dhe hyrë në cilëndo pjesë që Ai i urdhëron ata të shkojnë. Për këtë shkak, Allahu na paralajmëron:

"Vërtet, ka kujdestarë të ndershëm [dmth engjëj] mbi ju që shënojnë [veprat e juaja]. Ata dinë për gjithë çfarë bëni". [el-Infitar, 10-12]

Allahu e thotë këtë me qëllim që të na paralajmërojë. Kjo është fryt i besimit në engjëjt - që personi të ruhet nga thëniet dhe veprat e këqija, të cilat do të shënoheshin kundër tij dhe për të cilat ai do të merrej në llogari në Ditën e Gjykimit.

Asnjë gjë s'është e fshehur nga Allahu

Allahu thotë:

"S'ka njeri veçse ai ka një kujdestar [engjëll] mbi veten e vet".[et-Tarik, 4]

Dhe thotë:

"Ne jemi më afër tij sesa damari i qafës".[Kaf, 16]

A e di çfarë do të thotë "el-Uerid" këtu? Damari i qafës i njeriut është vena që është anash në qafë, nëpër të cilën rrjedh gjaku – një në të djathtë dhe një në të

majtë, në të dy anët e qafës. Në këta dy damarë rrjedh gjaku që furnizon trupin. Allahu thotë:

"Ne jemi më afër tij sesa damari i qafës".[Kaf, 16] Njëllor, Allahu thotë:

"Ai është i pari dhe i fundit, më i larti dhe më i afërti. Dhe, Ai është i gjithëdijshtëm për gjithçka".[el-Hadid, 3]

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selam, duke shpjeguar këtë ajet, tha:"Ti [O Allah] je i pari, kështu që s'ka gjë përpara Teje. Ti je i fundit, kështu që s'ka gjë pas Teje. Ti je më i larti, kështu që s'ka gjë mbi Ty. Dhe, Ti je më i afërti, kështu që s'ka gjë nën Ty".

Atëherë, asnjë gjë s'është e fshehur nga Allahu, qoftë kjo në tokë apo në det, në pjesët më të thella të shtëpisë personale, në shkretëtirë apo në treg, në xhami, në arenë dhe në hapësirat për zbavitje, në të gjitha vendet - ku Allahu dëgjohet, si edhe në vendet ku Ai kundërshtohet –

asnjë gjë s'është e fshehur nga Allahu, e as që është ndonjë gjë e mbuluar nga Ai. Për këtë shkak, kur Xhibrili ka pyetur peygamberin, salallahu alejhi ue selam, rreth *ihsanit*, ai u përgjigj duke thënë: "Kjo është ta adhurosh Allahun sikur ta shohësh. Por edhe nëse ti nuk e sheh Atë, vërtet Ai të sheh".

Kështu, personi mund ta kuptojë dhe të jetë i ditur rreth faktit që ai ka engjëj me vete dhe që Allahu thotë:

"Ne jemi më afër tij sesa damari i qafës. Kur dy pranuesit pranojnë [dmth shënojnë veprat e tij] nga e djathta dhe nga e majta e tij, të ulur. Ai nuk e thotë asnjë fjalë të vetme veçse ka një vëzhgues të gatshëm pranë tij [për ta shënuar atë]". [Kaf, 16-18]

Allahu thotë:

"Apo, mos po mendojnë që Ne nuk dëgjomë fshehtësitë dhe diskutimet

private të tyre? Natyrisht [që i dëgjojmë], dhe të dërguarit 'Tanë janë me ta duke shënuar [thëniet dhe veprat e tyre]".[ez-Zuhruf, 80]

"Të dërguarit 'Tanë" këtu i referohet engjëjve. Allahu dëgjon fshehtësitë dhe diskutimet private, dhe engjëjt e shënojnë atë. Kjo është nga ndikimi i besimit në engjëj.

Përmendja e engjëjve është për qëllimin e dashjes së tyre

Përmendja e engjëjve s'është vetëm për hir të njohjes së diçkaje, siç lexon ndokush në temën e historisë apo temë tjetër. Por, i përmendim engjëjt me qëllim që të jemi të përgatitur dhe të kujdesshëm për ta kur shkruajnë diçka rreth nesh, për të cilën do të merremi në llogari përpara Allahut. Madje, i përmendim ata për qëllimin e dashjes së tyre, meqë Allahu, më i larti, i do ata. I duam ngaqë janë krijesat më të dëgjueshme të Allahut, siç thotë Ai:

"Të ndershëm dhe të bindur".[Abese, 16]

Ajo që është e rëndësishme është që pranojmë rëndësinë dhe statusin e engjëjve dhe që i duam ngaqë Allahu i do. Për sa i përket atij që mban urrejtje ndaj engjëjve dhe i armiqëson, atëherë Allahu vërtet është armik i tij. Dhe, kushdo që merr Allahun për armik, ai s'do të jetë në gjendje të rezistojë dhe s'do të jetë në gjendje të lakmueshme.

Allahu thotë:

"Kushdo që është armik i Allahut, engjëjve të Tij, të dërguarve të Tij, Xhibrilit dhe Mika'ilit, atëherë vërtet, Allahu është armik i mosbesimtarëve".[el-Bekareh, 98]

Pra, kushdo që i konsideron armiq engjëjt, Allahu bëhet armik i tij.

Lus Allahun t'ju pajisë me besim të vërtetë, dije të dobishme dhe vepra të drejta. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi pejgamberin tonë Muhamed, mbi familjen e tij dhe shokët e tij.

Përmbajtja

Hyrje.....	2
Domethënia e besimit në engjëjt	7
Prej çfarë qenë krijuar engjëjt?.....	8
Disa nga detyrat e tyre	17
Numri i engjëjve që mbartin Fronin:	18
Cilësitë e Xhibrilit.....	21
Të shikuarit e Muhamedit Xhibrilin.	22
Çdo qenie njerëzore ka dy engjëj me vete	29
Thirrje për të shkujdesurin	33
Obligimi i të besuarit në engjëjt dhe të gjitha detyrat e tyre	37
Vendet që shpesh vizitohen nga engjëjt.....	40
Vendet që shpesh vizitohen nga djajtë	41

Ndikimi që ka besimi në engjëjt në jetën e njerëzve	43
Asnjë gjë s'është e fshehur nga Allahu	45
Përmendja e engjëjve është për qëllimin e dashjes së tyre	48